

UNIVERSITETI AAB
FAKULTETI JURIDIK

Lënda: VETËQEVERISJA LOKALE

Studime të programit Bachelor

Semestri i katërt

Mësimdhënësi: Mr.sc. Haxhi Metaj

E-mail: profi_meta@hotmail.com

Viti akademik 2014/2015

QËLLIMI I LËNDËS MESIMORE

Qëllimi i studimit të kësaj lënde është që të studiohen dhe trajtohen dispozitat juridike, kartat dhe konventat ndërkombëtare, si dhe praktikrat e qeverisjes së mirë që referohen fushës së vetëqeverisjes lokale e sidomos organizimi dhe funksionimi I vetëqeverisjes lokale në Kosovë.

Studentët nëpërmes kësaj lënde do të fitojnë njohuri themelore lidhur me parimet themelore të organizimit dhe funksionimit të vetëqeverisjes lokale, kuptimin e vetëqeverisjes lokale, aspektet kushtetuese të vetëqeverisjes lokale, zhvillimin historik të vetëqeverisjes lokale, bazen juridike të funksionimit të vetëqeverisjes lokale, përgjegjësitë dhe kompetencat e autoriteteve lokale, fusha e shtrirjes së vetëqeverisjes lokale, organet e vetëqeverisjes lokale, financimi i vetëqeverisjes lokale, transparenca e organeve të vetëqeverisjes lokale, mbrojtjen ligjore të vetëqeverisjes lokale, raportet e nivelit qendror dhe lokal, bashkëpunimi ndërkombëtar etj.

I. Metodrat të cilat do të përdoren gjatë ligjerimit të lëndës “ vetëqeverisja lokale”

1. Metodrat e mësimdhënjes aktive:

Nëpërmes kësaj metode do të shpjegohen dhe do të përkufizohen nocionet bazë të institucioneve të vetëqeverisjes lokale, rolin e parimeve në të cilat duhet të mbështetet funksionimi dhe organizimi i vetëqeverisjes lokale me qëllim të arritjes së objektivave të vetëqeverisjes lokale.

2. Metoda e mësimdhënjes inter-aktive:

Duke patur parasysh faktin se në qendër të studimeve është dhe duhet të jetë studenti, mësimdhënësit i mbetet të aktivizojë studentin në dhënjen e përkufizimeve dhe të bëjë interpretime kryesore nga fusha e vetëqeverisjes lokale. Qëllimi i kësaj metode është që studentëve t'u mundësohet që gjatë studimeve të jenë sa më aktiv, dhe të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e kësaj lënde që veçohet për nga specifikat që i ka.

3. Metoda krahasuese (komparative) :

Me anë të kësaj metode studentëve do t'u mundësohet njohja dhe krahasimi i ligjeve, kartës evropiane mbi vetëqeverisjen lokale, konventave ndërkombëtare, akteve tjera nënligjore, institucioneve dhe mekanizmave tjerë që aplikohen në fushën e vetëqeverisjes lokale. Njëkohësisht, studentët me anë të kësaj metode do të aftësohen që të bëjnë krahasimin e legjislacionit pozitiv të vendeve të ndryshme, si dhe pajtueshmërinë e legjislacionit vendor në krahasim me legjislacionin ndërkombëtar.

II. Rezultatet e pritura në raport me qëllimin

1. Studentët duhet të jenë të përgatitur për njohjen e nocioneve dhe koncepteve themelore të organizimit dhe funksionimit të vetëqeverisjes lokale.
2. Studentët do të përgatiten për të bërë një vlerësim kritik të organizimit dhe funksionimit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë, duke perceptuar kahjet e këtij zhvillimi me qëllim që vetëqeverisja lokale në Kosovë të jetë në funksion të misionit të vet të ofrimit të shërbimeve sa më të leta dhe më të afërta për qytetarët.
3. Pas përfundimit të ligjeratave studentët duhet të aftësohen në kuptimin e parimeve të funksionimit të vetëqeverisjes lokale dhe me propozimet dhe idetë e tyre duhet të perceptojmë zhvillimin e saj të mëtejshme në Kosovë.

III. Rëndësia e ligjeratave dhe ushtrimeve si dhe kërkesat që duhet tu përmbahen studentët

Ligjerat dhe ushtrimet janë pjesë më vitale e procesit mësimor. Ato do të mbahen në pajtim me planin mësimor dhe në pajtim me metodat e parapara në këtë plan. Prandaj, pjesëmarrja në to është e obliguar.

IV. Studentët të cilët do të dëgjojnë këtë lëndë, duhet tu përmbahen kritereve si ne vijim:

- të marrin pjesë në ligjerata
- të marrin pjesë në ushtrime
- të marrin pjesë në prezente
- të marrin pjesë në debate që organizohen gjatë mbajtjes së ligjeratave dhe ushtrimeve
- të punojnë punime seminarike

- V.** Studentët kanë për obligim të marrin pjesë në provimet me shkrim në formë të testit (kollokvium) ose në formë të esesë. Për mënyrën e mbajtjes së provimit me shkrim dhe kohës së mbajtjes do të njoftohen me kohë. Mospjesëmarrja në provime (me perjashtim të rasteve të arsyshme) pamundëson marrjen e notës positive në këtë lëndë mësimore.

VI. Plotësimi i kërkesave të shtruara më lart vlerësohet si në vijim:

Pjesëmarrja e rregullt në ligjerata ushtrime	10 %.
Angazhimet në orët e ushtrimeve	10 %.
Testi	20 %.
Punimet seminarike me shkrim dhe të mbrojtur publikisht	20 %.
Provimi përfundimtar	40 %.
<hr/>	
Gjithsej	100 pikë

VII. Sistemi i vlerësimit:

Nën 60 pikë	vlerësohet me note jokaluase.
61 – 69 pikë	vlerësohet me note gjashtë (6).
70 – 79 pikë	vlerësohet me note shtatë (7).
80 – 89 pikë	vlerësohet me note tetë (8).
90 – 95 pikë	vlerësohet me note nëntë (9).
96 – 100 pikë	vlerësohet me note dhjetë (10).

PLANI MËSIMOR

Plani mësimor i ligjeratave dhe ushtrimeve i detaizuar sipas orarit të ligjeratave

Java e parë

Raportet në mes nivelit lokal dhe qendror

- Parimet e përgjithshme.
- Llojet e mbikqyrjeve administrative.
- Mbikqyrja administrative.
- Procedurat e mbikqyrjes.
- Shkarkimi i kuvendeve komunale.

Java e dytë

Prejardhja dhe zhvillimi i Vetëqeverisjes lokale

- Zanafilla e vetëqeverisjes lokale.
- Zhvillimi historik i vetëqeverisjes lokale në Kosovë.
 - Vetëqeverisja lokale në Kosovë në periudhën 1946 – 1963.
 - Vetëqeverisja lokale në Kosovë në periudhën 1963 – 1974.
 - Vetëqeverisja lokale në Kosovë në periudhën 1974 – 1990.
 - Vetëqeverisja lokale në Kosovë në periudhën 1990 – 1999.
- Organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë në vitin 1999 - 2000.
- Organizimi dhe funksionimi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë në vitin 1999 – 2008.
 - Aspektet Demografike dhe territoriale të Komunave të Kosovës duke i krahasuar me standardet dhe kriteret e kartës evropiane mbi vetëqeverisjen lokale.
 - Aspektet krahasuesetë numrit të anëtarëve të Kuvendeve Komunale.
- Zgjedhjet Lokale, pjesëmarrja, sistemi zgjedhor dhe karakteristika tjera të zgjedhjeve lokale në Kosovë.

Java e tretë

Bashkëpunimi ndërkomunal

- Aspektet ligjore të bashkëpunimit ndërkomunal.
- Format e bashkëpunimit të brendshëm ndërkomunal.
- Format e bashkëpunimit ndërkombëtar.
- Bashkëpunimi ndërkufitar.
- Partneriteti ndërkomunal.

Java e katërt

Aktet komunale dhe transparenca komunale

- Statuti i komunës.
- Rregulloret lokale.
- Aktet e përgjithshme dhe individuale komunale.
- Transparenca komunale dhe mekanizmat e pjesmarrjes së qytetarëve.
Tubimet publike
Peticionet
Referendumi

Java e pestë

Kryetari i komunës

- Zgjedhja e Kryetarit.
- Përgjegjësitë e Kryetarit.
- Nënkryetari/ët i/e komunës.
- Shkarkimi i kryetarit.
- Bordi i drejtorëve, shërbimi civil komunal.

Java e gjashtë

Organet komunale

- Kuvendi i komunës.
- Funksionet e Kuvendit të komunës.
- Të drejtat dhe përgjegjësitë e kshilltarëve.
- Komitetet e Kuvendit Komunal.

Java e shtatë

Reformimi i vetëqeverisjes lokale.

- Decentralizimi (koncepti).
- Dokumentet reformuese të pushtetit lokal në Kosovë.
- Shqyrtim kritik i marrëveshjes për zgjedhjen e statusit final të Kosovës - aneksi për decentralizim

Java e tetë

Financat komunale

- Parimet e kartes evropiane.
- Konventat ndërkombëtare për financa lokale
- Parimet themelore të financimit të komunave në Kosovë.
- Të hyrat vetanake – Llojet.
- Grandet qeveritare.

Java e nëntë

Punimi me shkrim (kollokvium).

Java e dhjetë

Baza juridike e Vetëqeverisjes lokale në Kosovë pas vitit 1999

- Rregullorja e UNMIK - ut 45/2000 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës.
- Rregullorja e UNMIK - ut 9/2001 për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Perkohshme në Kosovë.
- Rregullorja e UNMIK - ut 19/2001 mbi degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Perkohshme të Vetëqeverisjes.
- Rregullorja e UNMIK - ut 15/2005 për ndrshimin e rregullores nr. 19/2001 mbi degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Perkohshme të Vetëqeverisjes.
- Rregullorja e UNMIK - ut 30/2007 për ndrshimin e rregullores nr. 45/2000 mbi Vetëqeverisjen e komunave të Kosovës.

Java e njëmbëdhjetë

Prezentimi i punimeve seminarike

Java e dymbëdhjetë

Aspektet teorike të vetëqeverisjes lokale

- Kuptimi i vetëqeverisjes lokale
- Parimet themelore të funksionimit të vetëqeverisjes lokale
- Misioni i vetëqeverisjes lokale.
- Vetëqeverisja lokale si kategori e sistemit politik dhe kushtetues.
- Fusha e shtrirjes së vetëqeverisjes lokale.
- Burimet financiare të vetëqeverisjes lokale.
- Mardhëniet e organeve të pushtetit lokal dhe pushtetit qendror.
- Vetëqeverisja lokale dhe demokracia.
- Vetëqeverisja lokale dhe decentralizimi.

Java e trembëdhjetë

Përkufizimi juridik dhe kompetencat e komunave

- Përkufizimi i komunës.
- Statusi ligjor.
- Simbolet.
- Kompetencat e pushtetit të komunave.
- Kompetencat vetanake.
- Kompetencat e deleguara.
- Kompetencat e zgjeruara komunale.

LITERATURA

Prof.Dr. Kurtesh Saliu – E drejta Kushtetuese II

Prof. Dr. Arsim Bajrami – Teoria dhe Praktika Parlamentare

Rregullorja e UNMIK - ut 45/2000 mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës.

Rregullorja e UNMIK - ut 9/2001 për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Perkohshme në Kosovë.

Rregullorja e UNMIK - ut 19/2001 mbi degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Perkohshme të Vetëqeverisjes.

Rregullorja e UNMIK - ut 15/2005 për ndrshimin e rregullores nr. 19/2001 mbi degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Perkohshme të Vetëqeverisjes.

Rregullorja e UNMIK - ut 30/2007 për ndrshimin e rregullores nr. 45/2000 mbi Vetëqeverisjen e komunave të Kosovës.

Dokumenti “ Propozimi gjithpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës.

Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale

Ligji mbi Kufijtë e Komunave

Ligji për Financat e Pushtetit Lokal